



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 3 Datë 05. 09. 2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE”

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 gërma b; nenit 41, nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore“ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin – Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë:

V E N D O S I :

1-Të miratojë kërkesën e subjektit “**INHERITOR RESORT**” sh.p.k. me administrator Z.Angjelin FUSHA për leje për përdorim të burimit ujqor **Pus shpimi** për qëllime turistike, me vendndodhje në fshatin Mali -Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Koordinatat e pusit të shpimit: X – 46 31 962; Y – 43 81 685; Z – +35 m;

Thellësia e pusit : 31 m;

Diametri i pusit: 125 mm

Viti i hapjes së pusit: 2014

Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 0.2 l/sek.

Periudha e përdorimit të burimit ujqor: Qershor-Shtator.

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Martin PLLUMBI



KRYETAR
Paulin RADOVANI